

Prot 540

Data 20/10/2010



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
MINISTRI

Handwritten notes:
M. Baci
B. Baci
M. Baci
M. Baci
M. Baci

MIRATOHEM
Signature of Sokol Ollashi
SOKOL OLLASHI
MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT



MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

UDHËZIM

Nr. 26., datë 20.10.2010

(300/2008)

MBI RREGULLAT E PERGJITHSHME NE FUSHEN E SIGURISE
SE AVIACIONIT CIVIL

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, Ligjit Nr.10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me Ligjin Nr.9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish Republikës së Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një Zone të Përbashkët Evropiane të Aviacionit”,

UDHEZOJ :

Neni 1

Objektivi

1. Ky udhëzim parashikon rregulla të përgjithshme për mbrojtjen e aviacionit civil nga akteve të nderhyrjes së paligjshme që rrezikojnë sigurinë e aviacionit civil. Gjithashtu vendos bazat për një interpretim të saktë të Aneksit 17 të ICAO-s.
2. Menyrat e arritjes së objektivave të lartpërmenduar janë:
 - (a) Vendosja e rregullave të përgjithshme dhe standarteve baze për sigurinë e aviacionit;
 - (b) mekanizma për monitorimin e pajtueshmërisë.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim do zbatohet nga:
 - (a) të gjithë aeroportet apo pjesët e aeroporteve që nuk përdoren ekskluzivisht për qëllime ushtarake;
 - (b) të gjithë operatorët, duke përfshirë dhe transportuesit ajrorë, që sigurojnë shërbime tek aeroportet e referuara në pikën (a);
 - (c) të gjitha entitetet që aplikojnë standartet e sigurisë së aviacionit që operojnë nga godina brenda ose jashtë hapësirave të aeroportit dhe sigurojnë dhe/ose shërbime për ose nepermjet aeroporteve referuar në pikën (a).

Neni 3

Perkufizimet

Per qellimin e ketij Udhezimi:

1. "Aviacioni Civil" nenkupton cdo operacion ajror te kryer nga nje avion civil, duke perjashtuar operatione te bera nga avionet shteterore, sipas parashikimit te nenit 3te Konventes se Cikagos.
2. "Siguria e aviacionit" nenkupton kombinimin e masave, burimeve njerezore dhe materiale me qellim mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e nderhyrjes se paligjshme qe rrezikojne sigurine e aviacionit civil.
3. "Operator" nenkupton nje person, organizate ose siper marrje te angazhuar ose qe ofrohet per tu angazhuar, ne operacionet e transportit ajror.
4. "Transportues Ajror" nenkupton nje siper marrje te transportit ajror qe zoteron nje licence operimi te vlefshme;
5. "Entitet" eshte nje person, organizate ose siper marrje, jo operator.
6. "Artikuj te ndaluar" jane armet, eksplozivet ose pajisje te tjera te rrezikshme, artikuj ose substance qe mund te perdoren per te kryer nje akt te nderhyrjes se paligjshme qe rrezikon sigurine e aviacionit civil;
7. 'Skanimi' nenkupton aplikimin e pajisjeve teknike qe kane per qellim te identifikojne dhe/ose te zbulojne artikuj te ndaluar;
8. "Kontrolli i Sigurise" do te thote aplikimin e mjeteve nepermjet te cilave perdorimi i artikujve te ndaluara mund te parandalohet.
9. "Akses Kontrolli" nenkupton aplikimin e mjeteve nepermjet te cilave hyrja e personave te paautorizuar apo automjeteve te paautorizuara, ose te dyjave, mund te parandalohet;
10. "Zona Ajrore" nenkupton zonen e levizjes ne nje aeroport, terreni i afert dhe ndertesat ose pjese te tyre, aksesit ne te cilat eshte i kufizuar;
11. "Zona Tokesore" nenkupton ato pjese te nje aeroporti, terreni te afert dhe ndertesat qe nuk jane pjese e Zones Ajrore.
12. "Zona e kufizuar e sigurise" nenkupton ate siperfaqe te zones ajrore ku, pervec aksesit te kufizuar, aplikohen edhe standarte te tjera te sigurise se aviacionit.

13. "Siperfaqja e kufirit" është ajo zone që është e ndare nga mjetet e akses kontrollit edhe nga zona e kufizuar e sigurisë, ose nëse zona e kufirit në vetvete është një zonë e kufizuar e sigurisë nga zona të tjera të kufizuara të sigurisë të një aeroporti;

14. "Kontrolli i dosjes personale" nënkupton një kontroll të identitetit të një personi, ku përshihet çdo histori kriminale, si pjesë e vlerësimit për pershtatshmeri individuale për akses të pashoqeruar në një zonë të kufizuar të sigurisë;

15. "Transferimi i pasagjereve, bagazheve, kargos dhe postes" nënkupton pasagjeret, bagazhet, kargot ose posta që nisen me një avion të ndryshëm nga ai që mberrihen;

16. "Pasagjeret, bagazhet, kargot ose posta tranzit" nënkupton pasagjeret, bagazhet, kargot ose posta që nisen nga i njëjti avion që mberrihen;

17. "Pasagjer i mundshëm problematik" është një pasagjer që është i debuar, ose një person që vlerësohet të jetë i papranueshëm për arsye imigrimi ose si person nën kujdestari të ligjshme.

18. "Bagazh i kabines" është bagazhi që mbahet në kabinën e avionit;

19. "Bagazhi" është bagazhi që futet në barkun e avionit;

20. "Bagazh i shoqeruar" është bagazhi që futet në barkun e avionit, dhe është kontrolluar për fluturimin së bashku me pasagjerin që udhëton me të njëjtin fluturim;

21. "Posta e transportuesit ajror" është posta, origjina dhe destinacioni i së cilës janë transportuesi ajror;

22. "Materialet e kompanive ajrore" janë materialet, origjina dhe destinacioni i së cilëve janë transportuesi ajror ose që perdoren nga një transportuesi ajror.

23. "Poste" nënkupton dergimin e korespondencës dhe artikuj të tjerë, me përjashtim të postes së transportuesve ajrore, i paraqitur nga dhe i destinuar për shërbime postare në përputhje me rregullat e zbatueshme;

24. "Kargo" nënkupton çdo prona e destinuar për tu mbajtur në avion me përjashtim të bagazhit, postes, postes së transportuesit ajror, materialeve të transportuesit ajror dhe furnizimeve të fluturimit.

25. "Agjent i rregulluar" nënkupton një transportues ajror, agjent, derguesi i ngarkesës ose çdo entitet tjetër që siguron kontrolle sigurie në lidhje me kargot dhe posten;

26. "Dorezues i njohur" është një dorezues që nis kargo ose poste për llogari të vet dhe procedurat e të cilit përputhen me rregullat e përgjithshme të sigurisë dhe standartet e mjaftueshme për të lejuar ngarkimin e kargos ose postes në çdo avion.

27. "Dorezuesi pergjegjes" nenkupton dorezuesin qe nis kargo ose poste per llogari te tij dhe procedurat e te cilit perputhen me rregullat e pergjithshme te sigurise dhe standartet e mjaftueshme qe lejojne ngarkimin e asaj kargo ne te gjithe avionet e mallrave ose posten ne te gjithe avionet e postes.

28. "Kontrolli i sigurise se avionit" nenkupton nje inspektim te atyre pjeseve te brendeshme te nje avioni, ne te cilat pasagjeret mund te kene pasur akses, bashke me nje inspektim te vendqendrimin te bagazheve te dores se avionit, ne menyre qe te zbulohen artikujt e ndaluar dhe nderhyrje te paligjshme ne avion.

28. "Kerkim i sigurise se avionit" nenkupton nje inspektim te brendshem dhe te jashtem te avionit ne pjeset e aksesueshme te tij ne menyre qe te zbulohen artikuj te ndaluar dhe nderhyrje te paligjshme qe rrezikojne sigurine e avionit.

29. "Oficer i sigurise gjate fluturimit" eshte nje person qe eshte i punesuar nga shteti per te udhetuar ne nje avion te nje transportuesi ajror licensuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, me qellimin per te mbrojtur avionin dhe perdoruesit e tij kunder akteve te nderhyrjes se paligjshme qe rrezikojne sigurine e fluturimit.

Neni 4

Standartet e pergjithshme baze

1. Standartet e pergjithshme baze per mbrojtjen e aviacionit civil kunder akteve te nderhyrjes se paligjshme qe rrezikojne sigurine e aviacionit civil duhet te jene ashtu sic eshte theksuar ne Aneksin qe i bashkelidhet ketij udhezimi dhe qe perben pjese integrale te tij.

2. Standartet e pergjithshme baze kane te bejne me:

- (a) metodat e skanimit te lejuara;
- (b) kategorite e artikujve te ndaluar;
- (c) akses kontrollin, bazat per dhenjen e aksesit ne zonen ajrore dhe zonat e kufizuara te sigurise;
- (d) metoda te lejuara per kontrollin e automjeteve, kontrole te sigurise dhe kerkime te sigurise se avioneve;
- (e) kriteret per pranimin e standarteve te sigurise ekuivalente te vendeve te tjera;
- (f) kushte nen te cilat kargot dhe posta duhet te skanohen ose te jene subjekt per kontrole te tjera te sigurise, gjithashtu dhe procesi per aprovimin e miratimit te agentit te rregulluar, dorezues te njohur dhe dorezues te miratuar;
- (g) kushte nen te cilat posta dhe materialet e transportuesve ajrore duhet te skanohen ose ti nenshtrohen ndonje kontrolli tjetër sigurie;

- (h) kushte nen te cilat furnizimet e fluturimit dhe aeroportit duhet te skanohen ose ti nenshtrohen kontrolleve te tjera te sigurise, gjithashtu dhe procesi per aprovimin e miratimit te furnizuesit te rregullt dhe furnizuesit te njohur;
- (i) kriteret per te percaktuar pikat kritike, zonat e kufizuara te sigurise;
- (j) kriteret per rekrutimin e personelit dhe metodat e trajnimit;
- (k) kushte nen te cilat aplikohen procedura te vecanta te sigurise ose perjashtime nga kontrollet e sigurise dhe;

3. Masa te detajuara per implementimin e standarteve te pergjithshme baze, referuar paragrafit 2 duhe te perfshijne;

- (a) kerkesa dhe procedura per skanimin;
- (b) nje list me artikujt e ndaluar;
- (c) kerkesa dhe procedura per akses kontrollin;
- (d) kerkesa dhe procedura per kontrollin e automjeteve, kontrolle te sigurise dhe kerkime te sigurise se avioneve;
- (e) vendimi per te njohur standartet e sigurise te njevlfishme te aplikuar nga vendet e tjera;
- (f) masa ne lidhje me kargon dhe posten, procedurat per aprovimin apo miratimin e tyre, dhe detyrimet per tu plotesuar prej agjenteve te rregulluar, dorezuesve te njohur dhe dorezuesve pergjegjes;
- (g) kriteret dhe procedura per kontrolle sigurie per transportuesit ajrore te postes dhe transportuesit ajrore te materialeve;
- (h) masa ne lidhje me furnizimet e fluturimit dhe te aeroportit, procedurat per aprovimin dhe miratimin e tyre, dhe detyrimeve per tu permbushur nga furnizues te rregulluar, dhe furnizues te njohur;
- (i) percaktimi i pjeseve kritike te zonave te kufizuara te sigurise;
- (j) rekrutimi i stafit dhe kerkesa per trajnimet;
- (k) procedura specifike sigurie ose perjashtime nga kontrolli i sigurise;
- (l) specifikime teknike dhe procedura per aprovimin dhe perdorimin e pajisjeve te sigurise; dhe;
- (m) kriteret dhe procedura ne lidhje me pasagjeret e mundshem problematik.

4. AAC dhe/ose institucione te tjera pergjegejse per sigurine ne aviacionin civil, duhet te sigurojne aplikimin e standarteve te pergjithshme baze te sigurise. Institucionet e lartpermendura nese kane aresye te besojne se niveli i sigurise se aviacionit eshte kompromentuar nepermjet nje thyerje te sigurise, duhet te ndermarrin veprime te shpejta dhe te pershtatshme per te korrigjuar ate thyerje dhe te sigurojne vazhdimesine e sigurise ne aviacionin civil.

Neni 5

Tarifa e sigurise

Kosto e sigurise qe derivon nga marrja e masave te sigurise per te mbrojtur aviacionin civil kunder akteve te nderhyrjes se paligjshme ne perputhje me kete Udhhezim, do te mbulohen nga: shteti, entitetet e aeroportit, transportuesit ajrore, agjensi te tjera pergjegjese ose perdoruesit.

Tarifa e sigurise eshte e lidhur me koston e ofrimit te sherbimeve te sigurise dhe duhet te perlllogaritet ne menyre te tille qe te mos tejkaloje koston e ketij sherbimi.

Neni 6

Masa me te rrepta sigurie

1. Ne baze te nje vleresimi te rrezikut dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, AAC mund te aplikojte masa me te rrepta sigurie sesa standartet e pergjithshme baze. Keto masa duhet te jene te pershtatshme, objektive, jodiskriminuese dhe ne perpjekje me rrezikun qe konstaton.

2. AAC publikon ne faqen elektronike standartet me te rrepta te sigurise.

3. AAC mund te mos publikojte standartet me te rrepta te sigurise nese masat jane te limituara per nje fluturim te caktuar ne nje date te caktuar.

Neni 7

Monitorimi dhe implementimi i standarteve te pergjithshme baze

Autoriteti i Aviacionit Civil eshte pergjegjes per koordinimin dhe monitorimin e zbatimit te standarteve te pergjithshme baze.

Neni 8

Programi Kombetar i Sigurise se Aviacionit Civil

1. Programi kombetar i sigurise se aviacionit civil, i cili permban te gjitha masat per mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e nderhyrjes se paligjshme, ne perputhje me detyrimet nderkombetare te Republikes se Shqipërisë, percakton gjithashtu pergjegjesite per implementimin e standarteve te pergjithshme baze dhe pershkruan masat e kerkuara nga operatoret dhe entitetet e tjera per kete qellim.

2. AAC duhet te siguroje zbatimin e programit kombetar te sigurise se aviacionit civil. AAC duhet te siguroje me shkrim mbi bazen e nevojës per tu informuar, pjese te caktuara te programit kombetar te sigurise se aviacionit civil, per operatoret dhe subjekte te tjera kur cmon se kane interes te ligjshem.

Neni 9

Programi kombëtar i kontrollit të cilësisë

1. Programi kombëtar për kontrollin e cilësisë së sigurisë së aviacionit civil përmban masat e nevojshme të monitorimit të kontrollit të cilësisë, të marra për vlerësimin e vazhdueshëm të zbatimit të programit kombëtar për sigurinë e aviacionit civil, përfshirë dhe politikën ku bazohet ky program.
2. Masat e programit kombëtar të kontrollit të cilësisë së sigurisë së aviacionit civil janë të detyrueshme për çdo person ose ent, subjekt i këtij programi.
3. Ky program duhet të mundësojë kontrollin e cilësisë së sigurisë së aviacionit civil, në mënyrë që të monitorojë sigurinë në përputhje edhe me këtë udhëzim edhe me programin kombëtar të sigurisë së aviacionit civil.
Programi duhet të lejojë për një zbulim të shpejtë dhe korrigjim të mangësive. Gjithashtu duhet të mundësojë që të gjithë aeroportet, operatorët dhe subjektet përgjegjëse për implementimin e standardeve të sigurisë së aviacionit që janë të vendosura në territorin e shtetit shqiptar duhet të jenë të monitoruara në mënyrë të rregullt, drejtperdrejt nga, ose nën supervizionin e AAC-se.

Neni 10

Programi i sigurisë së Aeroportit

1. Cdo Operator Aeroportual duhet të hartojë, aplikojë dhe mirëmbajë një program të sigurisë së aeroportit.
Ky program duhet të përshkruajë metodat dhe procedurat që duhen ndjekur nga operatori aeroportual në mënyrë që të respektojë parashikimet e këtij udhëzimi dhe parashikimet e programit kombëtar të sigurisë së aviacionit civil të shtetit shqiptar.
Programi duhet të përfshijë masa të brendshme të kontrollit të cilësisë që përshkruajnë se si pajtueshmëria me këto metoda dhe procedura duhet monitoruar nga operatori aeroportual.
2. Ky program i sigurisë së aeroportit duhet të paraqitet AAC-se, i cili mund të marrë vendimet e caktuara në lidhje me të.

Neni 11

Programi i sigurisë së transportuesve ajrore

1. Cdo transportues ajror duhet të hartojë, aplikojë dhe mirëmbajë një program të sigurisë së kompanisë ajrore.
Ky program duhet të përshkruajë metodat dhe procedurat të cilat duhen ndjekur nga transportuesi ajror në mënyrë që të përputhet me këtë Udhezim dhe me programin kombëtar të sigurisë së aviacionit civil të shtetit shqiptar nga i cili siguron shërbimet.

Programi duhet te perfshije masa te brendeshme te kontrollit te cilesise qe pershkruajne se si pajtueshmeria me keto metoda dhe procedura duhet monitoruar nga transportues ajror.

2. Mbi baze te kerkeses se AAC, programi i sigurise i kompanise ajrore duhet ti paraqitet AAC, i cili mund te marre vendimin e caktuar neqoftese eshte e nevojshme.

Neni 12

Programi i sigurise se entiteteve

1. Cdo entitet te cilit i kerkohet sipas programit kombetar te sigurise se aviacionit civil per te aplikuar standartet e sigurise se aviacionit duhet te hartoje, aplikojte dhe mirembaje nje program sigurie.

Ky program duhet te pershkruajte metodat dhe procedurat te cilat duhet te ndiqen nga entiteti ne menyre qe te pajtohet me programin kombetar te sigurise se aviacionit civil ne lidhje me opertimet e tij ne fushen e sigurise.

Programi duhet te perfshije masa te brendshme te kontrollit te cilesise qe pershkruajne se si pajtueshmeria me keto metoda dhe procedura duhet monitoruar nga vete entiteti.

2. Mbi baze te kerkeses se AAC, programi i sigurise se entitetit qe aplikon standartet e sigurise se aviacionit duhet t'i paraqitet AAC-se, qe mund te marre vendime te metejshme nese eshte e nevojshme.

Neni 13

Perhapja e Informacionit

Si rregull i pergjithshem, AAC duhet te publikoje masat qe kane nje efekt te drejtperdrejte te pasagjeret. Gjithsesi, dokumentat qe permbajne informacion te ndjeshem te sigurise si per shembull raportet e inspektimit te AAC, duhet te paraqiten si informacion konfidencial.

Neni 14

Hyrja ne fuqi

Ky udhezim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

ANEKSI

STANDARTET E PERGJITHSHME BAZE PER MBROJTJEN E AVIACIONIT CIVIL KUNDER AKTEVE TE NDERHYRJES SE PALIGJSHME

1. SIGURIA E AEROPORTIT

1.1 Planifikimi i kerkesave (nevojave) te aeroportit

1. Kur projektimi dhe konstruksioni i faciliteteve te reja ne aeroport kerkon implementimin e standarteve te pergjithshme baze te theksuara ne kete Aneks, implementimi i akteve te tij duhet te merret plotesisht ne konsiderate.
2. Neper aeroporte duhet te themelohen zonat e meposhtme;
 - (a) zona tokesore
 - (b) zona ajrore
 - (c) zonat e kufizuara te sigurise; dhe
 - (d) pjeset kritike te zonave te kufizuara te sigurise.

1.2 Akses kontrolli

1. Aksesimi ne zonat ajrore duhet te jete i kufizuar ne menyre qe te parandalohen persona te paautorizuar dhe automjete per te hyre ne keto zona.
2. Aksesimi ne zonat e kufizuara te sigurise duhet te kontrollohet ne menyre qe te sigurohet qe asnje person apo automjet i paautorizuar te hyje ne keto zona.
3. Persona dhe automjete mund te kene akses ne hapesiren ajrore dhe zonat e kufizuara te sigurise vetem nqs ata plotesojne kushtet e kerkuara te sigurise.
4. Persona, duke perfshire dhe anetaret e stafit te fluturimit, duhet te kene permbushur ne menyre te suksesshme nje kontroll te dosjes personale perpara marrjes se kartes se identitetit si ekuipazh ose karten e identitetit te aeroportit qe autorizon akses te pashoqeruar per ne zonat e kufizuara te sigurise.

1.3 Skanimi i personave qe nuk jane pasagjer ose furnizues

1. Personat qe nuk jane pasagjere, bashke me furnizuesit, duhet te skanohen ne baze te nje kontrolli rutine para se te hyjne ne zonat e kufizuara te sigurise ne menyre qe te parandalohet futja e artikujve te ndaluar ne keto zona.
2. Te gjithë personat qe nuk janë pasagjere, bashke me furnizuesit duhet te skanohen para hyrjes ne zonat e sigurise ne menyre qe te parandalohet futja e artikujve te ndaluar ne keto zona.

1.4 Ekzaminimi i automjeteve

Automjetet që hyjnë në zonat e kufizuara të sigurisë duhet të kontrollohen në mënyrë që të parandalohen futjet e artikujve të ndaluar në këto zona.

1.5 Mbikqyrja, patrullimi dhe kontrole të tjera fizike

Duhet të këtu mbikqyrje, patrullim dhe kontrole të tjera fizike nëpër aeroporte dhe, aty ku është e përshatshme, në zonat afër aksesit publik, në mënyrë që të identifikohen sjelleje të dyshimta të personave, të identifikohen dobesi të cilat mund të përdoren për të bërë një veprim të nderhyrjes së paligjshme dhe për të ndaluar persona para se të kryejnë akte të tilla.

2. ZONAT KUFITARE TË AEROPORTEVE

Avionet e parkuar në zonat kufitare të aeroporteve në të cilat aplikohen masa alternative duhet të jenë të ndara nga avionet në të cilët zbatohen plotësisht standartet e përgjithshme baze, në mënyrë që të sigurohet që standartet e sigurisë që aplikohen tek avionet, pasagjeret, bagazhet, kargot dhe posta nuk janë të rrezikuara.

3. SIGURIA E AVIONEVE

1. Përpara nisjes, një avion duhet të jetë subjekt i një kontrolli sigurie ose kërkimi sigurie në mënyrë që të garantohet që asnjë artikull i ndaluar është i pranishëm në bord. Një avion në tranzit duhet të i nënshtrohet masave të tjera të përshatshme.

2. Çdo avion duhet të mbrohet nga nderhyrjet e paligjshme.

4. PASAGJERET DHE BAGAZHET E KABINES

4.1 Skanimi i pasagjereve dhe bagazheve të kabines

1. Të gjithë pasagjeret dhe bagazhet e drejtperdrejta dhe tranzite duhet të skanohen në mënyrë që të parandalohet futja e artikujve të ndaluar në zonat e kufizuara të sigurisë dhe në bordin e avioneve.

4.2 Mrojtja e pasagjereve dhe bagazheve të kabines

1. Pasagjeret dhe bagazhet e kabines duhet të mbrohen nga nderhyrjet e paligjshme që nga momenti kur ato skanohen deri në nisjen e avionit me të cilin fluturojnë.

2. Pasagjeret në nisje të skanuar nuk duhet të bashkohen me pasagjeret në ardhje.

4.3 Pasagjeret e mundshem problematik

Perpara nisjes pasagjeret e mundshem problematik duhet t' i nenshtrohen masave te pershtatshme te sigurise.

5. BAGAZHET E MEDHA

5.1 Skanimi i bagazheve te medha

1. Te gjitha bagazhet e medha duhet te skanohen perpara se te futen ne avion ne menyre qe te parandalohet futja e artikujve te ndaluar ne zonat e kufizuara te sigurise dhe ne bordin e avionit

2. Bagazhet e medha tranzite mund te perjashtohen nga skanimi nese qendrojne ne bordin e avionit.

5.2 Mbrojtja e bagazheve te medha

Bagazhet e medha qe te ngarkohen ne nje avion duhet te mbrohen nga nderhyrjet e paligjshme qe nga momenti qe skanohen apo merret nen kujdes te kompanise ajrore deri ne nisjen e avionit ne te cilin do ngarkohen.

5.3 Bashkerendimi i bagazheve

1. Cdo artikull i bagazheve duhet te identifikohet si i shoqeruar ose i pashoqeruar.

2. Bagazhet e pashoqeruara nuk duhet te transportohen, me perjashtim kur ato bagazhe ose jane ndare pertej kontrollit te pasagjereve ose i jane nenshtruar kontrolleve te caktuara te sigurise.

6. KARGO DHE POSTA

6.1 Kontrollet e sigurise per kargot dhe posten

1. Te gjitha kargot dhe posta duhet t' i nenshtrohen kontrolleve te sigurise perpara se te ngarkohen ne avion. Nje kompani ajrore nuk duhet te pranoje ngarkimin ne avion te kargos apo postes nqs nuk ka aplikuar vete kontrolle ose qe aplikimi i tyre nuk eshte konfirmuar nga nje agjent i rregullt, dorezues i njohur apo dorezues i rregullt.

2. Kargo dhe posta e transferuar mund t' i nenshtrohen kontrolleve alternative te sigurise qe jane te detajuara ne nje akt te implementuar.

3. Kargo dhe posta tranzit mund të perjashtohen nga kontrollet e sigurisë nëse qëndrojnë në bordin e avionit.

6.2 Mbrojtja e kargos dhe postës

1. Kargo dhe posta që do të ngarkohen në një avion duhet të mbrohen nga nderhyrjet e paligjshme që nga momenti që aplikohen kontrollet e sigurisë deri në nisjen e avionit në të cilit do të ngarkohen.

2. Kargo dhe posta që nuk janë të mbrojtur në mënyrë të përshtatshme nga nderhyrjet e paligjshme pasi janë bërë kontrollet e sigurisë duhet të skanohen.

7. POSTA DHE MATERIALET E KOMPANIVE AJRORE

Posta dhe materialet e kompanive ajrore duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë dhe me pas të mbrohen deri sa të imbarkohen në avion në mënyrë që të parandalohet që artikujt e ndaluar të futen në bordin e avionit.

8. FURNIZIMI GJATE FLUTURIMIT

Furnizimi gjatë fluturimit, duke përfshirë dhe kateringun, me qëllim imbarkimin dhe përdorimin në bordin e avionit duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë dhe me pas të mbrohet deri kur të ngarkohet në avion në mënyrë që të parandalohet futja e artikujve të ndaluar në bordin e avionit.

9. FURNIZIMET E AEROPORTIT

Furnizimet me qëllim shitjen ose përdorimin në zonat e kufizuara të sigurisë të aeroporteve, duke përfshirë edhe furnizimet për dyqanet "duty-free", dhe restorantet, duhet t'i nënshtrohen kontrolleve të sigurisë në mënyrë që të parandalohet futja e artikujve të ndaluar në këtë zonë.

10. MASAT E SIGURISË GJATE FLUTURIMIT

1. Pa cenuar rregullat e aplikueshme të sigurisë së aviacionit;

(a) personat e paautorizuar duhet të parandalohen nga hyrja në pjesën e ekuipazhit gjatë fluturimit;

(b) pasagjerët e mundshëm problematik duhet t'i nënshtrohen masave të caktuara të sigurisë gjatë fluturimit;

2. Masat e caktuara të sigurisë, siç janë trajnimi i ekuipazhit të fluturimit dhe personelit të kabines duhet të merren që të parandalohen akte të nderhyrjes së paligjshme gjatë fluturimit.

3. Armet, me perjashtim te atyre qe mbahen ne bagazhin e avionit, nuk duhet te ngarkohen ne bordin e avionit, vetem ne rast se kushte te caktuara te sigurise ne perputhje me ligjet kombetare jane permbushur dhe eshte dhene autorizimi nga shtetet e perfshira.

4. Paragrafi i 3-te duhet gjithashtu te aplikohet per oficeret e sigurise gjate fluturimit nese ata mbajne arme.

11. REKRUTIMI I PERSONELIT DHE TRAJNIMI

1. Personat qe implementojne, ose qe jane pergjegjes per implementimin, skanimin, akses kontrollin apo kontrole te tjera te sigurise duhet te trajnohen dhe aty ku eshte e nevojshme, te certifikohen ne menyre qe ata te jene te pershtatshem per punesim dhe kompetent per te kryer detyrat per te cilat jane punesuar.

2. Personat qe nuk jane pasagjere dhe qe kerkojne leje per ne zonat e kufizuara te sigurise duhet te bejne trajnime per sigurine, perpara se te marrin karten e identifikimit te aeroportit ose karten e ekuipazhit.

3. Trajnimet, sic eshte permendur ne paragrafet 1 dhe 2 duhet te kryhen ne baza fillestare dhe te vazhdueshme.

4. Instruktoret qe do te bejne trajnimin e personave sipas paragrafit 1 dhe 2 duhet te kene kualifikimet e nevojshme.

12. PAJISJET E SIGURISE

Pajisjet e perdorura per skanimin, akses kontrollin dhe kontrollet e tjera te sigurise duhet te perputhen me specifikimet e percaktuara dhe te jene ne gjendje per te realizuar kontrollet e sigurise.